---

**PSH .nr. 308/20**

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi – Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: "MATKOS PHARM SH.P.K" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "Koslabor", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna nga LE për nevojat e SHSKUK-së-Lot 33" me nr. të prok: 00220-20-331-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/, më datën: 25.06.2020, mori këtë:

## V E N D I M

**I. APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "MATKOS PHARM SH.P.K" -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna nga LE për nevojat e SHSKUK-së-Lot 33" me nr. të prok:00220-20-331-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/.

**II. ANULOHET,** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna nga LE për nevojat e SHSKUK-së-Lot 33" me nr. të prok:00220-20-331-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/, dhe lënda kthehet në **rivlerësim.**

**III**. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV**. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

**V.** Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "MATKOS PHARM SH.P.K"-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "MATKOS PHARM SH.P.K"-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.05.2020 me nr. 308/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me barna nga LE për nevojat e SHSKUK-së-Lot 33" me nr. të prok:00220-20-331-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 59 dhe nenin 60 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.05.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues në ankesën e tij ka një pretendim lidhur me një kërkesë për sqarim që autoriteti kontraktues gjatë fazës së vlerësimit i ka dërguar OE ankues dhe për të njëjtën kërkesë OE ankues pretendon se AK-ja, e ka ngarkuar në një vend të gabuar dhe si rrjedhojë pretendon se nuk e kanë vërejtur.

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se pretendimi i OE ankues, është çështje teknike dhe për të dhënë një sqarim me të detajuar lidhur me këtë pretendim eksperti shqyrtues konform pretendimit të OE ankues ka kërkuar sqarim nga HelpDesku i KRPP-së.

Bashkangjitur me raport i gjeni të gjitha shkresat e lidhura me këtë pretendim dhe përgjigjen e HelpDeskut andaj duke u bazuar ne sqarimin e dhëne nga HelpDesku, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa është e pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 05.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 08.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.06.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik ankues, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "MATKOS PHARM SH.P.K"-Prishtinë se AK me datë kishte kërkuar sqarime shtesë përmes "Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit", ku këtë kërkesë AK e ka ngarkuar jo në faqen apo vendin për këtë aktivitet të prokurimit por në një vend krejt tjetër. Në vazhdim të pretendimit të OE ankues potencohet se si pasojë e mos ngarkesës së kërkesës për sqarime shtesë në vendin e duhur nga AK, për neve ka qenë e pamundur për që të gjejmë një kërkesë të tillë sepse ne e kemi përcjellë çdo kërkesë të AK-së pranë vendit përkatës dhe jo krejt diku tjetër. Më tej, OE ankues shton se mos përgjigja në kërkesën e AK-së për sqarime shtesë ka ndodhur për shkak të ngarkimit në vendin e gabuar dhe ky veprim është në kundërshtim me qëllimin e ligjit të LPP-së, konkretisht në kundërshtim me nenin 1 sepse qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike. Tutje, OE ankues shton se ky veprim i AK-së është në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të nenit 1 të LPP-së që kërkohet që të karakterizohet me jo diskriminim dhe më një shkallë të lartë të transparencës dhe dokumenti i ngarkuar në vendin e gabuar paraqet shkallë të lartë të jo transparencës dhe diskriminimit. Gjithashtu, OE ankues potencon se oferta e tyre është më e lirë në shumë prej 18,200 euro në krahasim më ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të cilat i ka bashkangjitur OE ankues dhe shqyrtimit të njoftimeve/dokumenteve të ngarkuara në platformën e e-prokurimit, sqaron se në faqen e-prokurimit për këtë

aktivitet të prokurimit, AK ka ngarkuar këto dokumente sipas kësaj renditje: me datë 11.03.2020 në ora 11:43:57 ka ngarkuar dosjen e tenderit, me datë 05.03.2020 në ora 13:36.06 ka ngarkuar dokumentin "pyetje & përgjigje.pdf", me datë 11.03.2020 në ora 11:44:56 ka ngarkuar dokumentin "informata shtesë.pdf", me datë 23.03.2020 në ora 08:19:40 ka ngarkuar dokumentin "vendim i përgjigjes për rishqyrtim.pdf", me datë 26.03.2020 në ora 12:26:59 ka ngarkuar dokumentin "proces verbali i hapjes së Tenderëve.pdf" dhe me datë 07.05.2020 në ora 13:37:48 ka ngarkuar dokumentin "Vendimi i Ak.PDF". Pra, Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të këtyre dokumenteve të ngarkuara vlerëson se AK nuk e ka ngarkuar "kërkesën për sqarime shtesë" të datës 07.04.2020 në vendin e duhur sikurse i kishte publikuar dokumentet e lartcekura. Andaj, duke pasur parasysh pretendimin e OE ankues që paragrafi 2 i nenit 1 të LPP-së kërkohet që të karakterizohet me jo diskriminim dhe më një shkallë të lartë të transparencës dhe dokumenti i ngarkuar në vendin e gabuar paraqet shkallë të lartë të jo transparencës dhe diskriminimit, Paneli Shqyrtues konsideron se është pretendim i bazuar sepse ky njoftim do duhej të publikohej sikurse njoftimet tjera siç janë përshkruar më lartë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "MATKOS PHARM SH.P.K"-Prishtinë se për shkak të mos përdorimit të duhur të platformës së e-prokurimit nga AK, detyrimisht shkel nenin 6 të LPP-së për shkak se secili AK është i obliguar që të siguroj që fondet publike dhe burimet publike të përdorën në mënyrën më ekonomike, përkundrazi AK e shpërblen me kontratë OE me çmim më të shtrenjtë prej 18,224.00 euro. Paneli Shqyrtues vlerëson se edhe ky pretendim është i bazuar pasi që oferta e OE ankues  është në shumë prej 95,676 euro, kurse oferta e OE të rekomanduar për kontratë është në shumë prej 113.900, pra OE ankues është më i lirë në shumë prej 18,224€ dhe duke pasur parasysh këtë fakt, rrjedhimisht AK nuk është siguruar që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrën me ekonomike konform nenit 6 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë publikimit të njoftimit lidhur me letrën standarde për sqarime shtesë nuk e ka publikuar në vendin e duhur me çka ka ndikuar që të mos arrihet që të zbatohet neni 1 dhe neni 6 i LPP-së, duke mos u siguruar që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit për shkak se OE ankues ka ofertuar me çmim më të lirë në shumë prej 18,224.00 euro. Për më tepër, AK nuk ka pasur në konsideratë edhe par.2 të nenit 1 sepse kjo dispozitë ligjore ka përcaktuar që vendimet duhet të karakterizohen me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës, si dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Andaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave të kërkoj sqarime shtesë nëse e sheh të nevojshme dhe të bëjë publikimin e njoftimeve në vendin e duhur me qëllim të shmangies së hutisë së operatorëve ekonomik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

**Vendimi t'i dorëzohet:**

1x1 AK- Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës /SHSKUK/

1x1 OE -"MATKOS PHARM SH.P.K"-Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.